



Eco-Higjiena Sh.p.k

Fehmi Agani pn. 60000 Gjilan

NRB: 70856514; NRF: 600816344;

Banka: Raiffeisen Bank:1507001004573148

Tel/Fax.: 0280 322415

E-mail: office@ecohigjiena.com ; Web: www.ecohigjiena.com

Datë 21.02.2013

Gjilan

Raporti i Punës për Kuvendin Komunal të Gjilanit

Për: Kryetarin e Komunës së Gjilanit, z.Qemajl Mustafa

Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Gjilanit z.Izmi Zeka

Nga: Bajram Isufi, Drejtor Ekzekutiv në Eco-Higjiena Shpk

**Eco-Higjiena Sh.p.k**

Fehmi Agani pn. 60000 Gjilan

NRB: 70856514; NRF: 600816344;

Banka: Raiffeisen Bank:1507001004573148

Tel/Fax.: 0280 322415

E-mail: office@ecohigjiena.com; Web: www.ecohigjiena.com

Njësia e Gjilanit në kuadër të Kompanisë “EcoHigjiena” sh.p.k. ka një administrim shumë të mire të punëve si në administratë po ashtu edhe në kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve në grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave në deponinë sanitare, si dhe në sipërfaqet publike

Mirëpo Kompania EcoHigjiena ka probleme dhe sfida të ndryshme si çdo kompani në Kosovë që kryen të njëjtën veprimtari.

Problemi kryesor dhe më i rëndësishëm është grumbullimi i mjeteve nga klientet tanë, që çdo ditë e më shumë, obligimi i qytetarëve ndaj kompanisë tone sa vie e rritet.

Pasi që Kompania jonë për shkak të veprimtarisë specifike që ka, nuk ka mekanizëm tjetër të përshtatshëm për inkasimin e mjeteve nga një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të cilët kanë mbetur mbrapa me pagesën e shërbimit, Kuvendi Komunal nga data 1 korrik të vitit 2011, ka nxjerrë një vendim për kushtëzimin e qytetarëve në lëshimin e disa dokumenteve.

Kushtëzimi për kryerjen e obligimeve nga ana e Kuvendit Komunal ndaj qytetarëve ka ndikuar jashtëzakonisht mirë në inkasim të mjeteve.

Në fillimi të aplikimit të kushtëzimit ka pasur reagime negative nga ana e qytetarëve të cilët nuk e kanë përkrahur. Zakonisht reagimet për mos përkrahje kanë ardhur nga ata të cilët kanë pasur obligime të mëdha.

Mirëpo ka pasur edhe reagime pozitive nga një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të cilët e kanë përkrahur kushtëzimin duke thënë “ se shërbimet e marura nga kompanija duhet të kryhen me rregull”.

Kushtëzimi nuk ka ndikuar njëjtë në të gjitha kategoritë e klientëve.

Në kategorinë e amvisnisë kushtëzimi ka ndikuar jashtëzakonisht mirë dhe kuota e 40% për pagesë të obligimeve ka rritur në këtë masë edhe të hyrat.

Ndërsa në kategorinë e bizneseve kushtëzimi nuk ka ndikuar po thuajse fare. Faktorët këtu janë nga më të ndryshmit, mos pranimi i regjistrimit të lokaleve, ndërrimi i shpeshtë i vendeve të lokaleve si dhe hapja dhe mbyllja pas dy-tre muajve etj.

Rezultati i kushtëzimit është evident në Njesinë e Gjilanit në kategorinë e amvisnisë.

**Eco-Higjiena Sh.p.k**

Fehmi Agani pn. 60000 Gjilan

NRB: 70856514; NRF: 600816344;

Banka: Raiffeisen Bank:1507001004573148

Tel/Fax.: 0280 322415

E-mail: office@ecohigjiena.com; Web: www.ecohigjiena.com

Për vitin 2011

Ky rezultat mund të shifet edhe nga shënimet e dalura nga periudha 6 mujore para kushtëzimit dhe në periudhën 6 mujore pas kushtëzimit.

Inkasimi **01.01.2011 deri 30.06.2011**

Inkasimi

01.07.2011 deri 31.12.2011Amvisni **159,650.00** Pa kushtëzim

Amvisni

286,500.50 Pas kushtëzimitLokale **38,368.22** Pa kushtëzim

Lokale

38,940.92 Pas kushtëzimit

Kushtëzimi ka vazhduar edhe në vitin 2012 me gjithë problemet dhe sfidat që kemi pasur me qytetarë të ndryshëm të cilët pasi që nuk kanë paguar me kohë të gjatë, borgji është rritur vazhdimisht dhe kanë bërë kërkesa të ndryshme për mos pranim të borgjit me arsyetime nga më të ndryshmet psh. disa thonë se “nuk hedhim fare mbeturina pasi që ato i dhezim në oborr te shtëpisë”, disa nuk e pranojnë se Kompania ju ka kryer shërbim etj.

Ne mendojmë se kushtëzimi i qytetarëve për nxerrjen e disa dokumenteve duhet të mbetet ende në fuqi, sepse me keqardhje e themi se disa qytetarë të pa ndërgjegjshëm duke e parë që EcoHigjiena nuk ka ndonjë mekanizëm tjetër për inkasimin e mjeteve siq e ka p.sh. KEK-u me ndaljen e rrymës ata shfrytëzojnë kryrjen e shërbimeve tona dhe nuk lodhen fare për kryerjen e obligimeve të tyre.

Po ashtu edhe në Komunën e Vitisë pas aplikimit të kushtëzimit nga Kuvendi Komunal është vërejtur rritja e inkasimit, edhe pse në Njësinë e Vitisë ka pasur më shumë probleme pasi që kjo njësi siq e dini ka qenë e ndarë nga Gjilani për tri vite.

Pas ndërprerjes së kushtëzimit në Njësinë e Vitisë, shifet qartë menjëherë një rënie e inkasimit edhe ashtu të ulët, shkalla e inkasimit është e dobët dhe atje jemi duke bërë përpjekje të vazhdueshme për mundësitë e ngritjes së Inkasimit dhe ngritjes së nivelit të punës nga kjo Njësi.

Në Njësinë e Vitisë duhet cekur se përveç që qytetarët dhe bizneset kanë obligime të shumta edhe vet Kuvendi Komunal nuk qëndron mirë sa i përket pagesave për shërbimet që u bën Njësia Komunës.

Komuna e Vitisë në bazë të Kontratës për Larje dhe pastrim të qytetit i ka borgj Kompanisë tonë mbi 20.000,00 €, dhe përkundër premtimeve të zyrtarëve komunal se do ti kryejnë pagesat, një gjë të tillë deri më sot nuk e kanë bërë.



Eco-Higjiena Sh.p.k

Fehmi Agani pn. 60000 Gjilan

NRB: 70856514; NRF: 600816344;

Banka: Raiffeisen Bank: 1507001004573148

Tel/Fax: 0280 322415

E-mail: office@ecohigjiena.com; Web: www.ecohigjiena.com

Me Komunën e Novobërdës shërbimet janë duke u kryer sipas planifikimeve të parapara. Në këtë Komunë edhe inkasimi është në nivel dhe me te hyrat që kjo njësi krijon mbulon teritorin e saj si për operative po ashtu edhe puntorë.

Kompania është në biseda me komunat e reja për marrëveshje të reja për ofrimin e shërbimeve tona gjegjësisht me Komunat Kllokot, Ranilluk, Partesh ku dy prej tyre janë arritur marrëveshjet.

Për shkak të inkasimit të dobët në këto komuna ne jemi fokusuar në marrëveshje kryesisht për ndarjen e obligimeve mes Kompanisë dhe Komunave, ashtu që komunat e reja të paguajnë një shumë fikse për shërbimet që EcoHigjiena i kryen ndaj tyre si lëshimi i faturave, dhënja në shfrytëzim e licences për kryerjen e shërbimeve nëpër komunat e tyre.

Komunat e reja obligohen që shpenzimet operative, pagat e personelit si dhe tatimet që dalin nga faturimi ti paguajnë vet ato.

Gjatë fundvitit 2012 dhe tani në vitin 2013, pas kalimit në Partneritet me Kompaninë Moser Group, Investitori ka filluar Investimet ku me këtë rast është finalizuar Administrata në Objektin e ri me: Kompjuter të rinj, Inventar të ri, Kushte të mira për puntor dhe planifikohet që muajin e ardhshëm të kalohet në objekt të ri. (8 mars 2013)

Gjatë këtij muaji investitori do ti sjellë me 28 Shkurt dy kamion të rinj për bartje të mbeturinave. Po ashtu kemi tre kontigjent me Kontejner të cilat janë sjellur nga Austria, ku me këtë rast banoret e lagjes Dheu i bardhë janë paisur komplet me kontejner dhe po vazhdohet me shpërndarjen e tyre.

Me rastin e furnizimit të klientëve me kontenjer familjar apo kontinjer për çdo shtëpi vërehet qartë një interesim i qytetarëve për kryerjen e obligimeve të mbetura si dhe interesimi për regjistrim i atyre qytetarëve të cilët për ndonjë arsye nuk kanë qenë të regjistruar apo nuk kanë dashur të regjistrohen.

Në Lagjen Dheu i Bardhë ku se fundi janë shpërndarë kontenjeret, inkasimi në muajin dhjetor dhe janar ka qenë dukshëm më i lartë se në muajt paraprak.

Edhe te qytetarët shprehet një gëzim për furnizim me kontenjer si dhe gadishmëri më e lartë për kryerjen e obligimeve ndaj EcoHigjienës.

Sipas të dhënave të Partnerit privat, furnizimi me kontinjer do të bëhet faza-faza për tërë qytetin e Gjilanit, me ç'rast do të krijohen kushte më të mira për një ambient të pastër dhe jetë më të shëndetshme për qytetarët e Gjilanit.

**Eco-Higjiena Sh.p.k**

Fehmi Agani pn. 60000 Gjilan

NRB: 70856514; NRF: 600816344;

Banka: Raiffeisen Bank:1507001004573148

Tel/Fax.: 0280 322415

E-mail: office@ecohigjiena.com; Web: www.ecohigjiena.com

Në vazhdim po i paraqesim investimet të cilat i ka bërë deri më tani partneri i ri.

Në këtë tabelë nuk janë të përfshirë dy Kamionë të cilët pritet të vijnë në fund të muajit shkurt 2013, po ashtu tek Parkingu i kamionëve ku parashifen disa rregullime gjate periudhës së ardhshme tre mujore

1	Garazha per mekanikë	25,000.00
2	Furnizimi me rrymë nga Trafoja deri te Objekti	3,754.50
3	Kyqja e rrymes te objekti i ri	1,539.91
4	Kontinjer kontigjenti I	14,548.40
5	Kontinjer kontigjenti II	19,031.04
6	Kontinjer kontigjenti III	19,645.12
7	Paisje të teknologjisë informatike, kompjuter, printer etj.	21,719.55
		105,238.52

Pëveq këtyre investimeve Partneri i ri Moser Group ka bërë edhe disa investime gjegjësisht shpenzime për krijimin e kushteve sa më të mira për kalimin në objektin e ri. Po punohet që në qendrën e qytetit të vendosen kontejner të rinj statik.

Dinamika e investimeve dhe punëve është duke shkuar sipas parashikimeve dhe planeve që janë premtuar nga partneri privat .

Sipas parashikimeve kalimi në Objektin e Ri do të bëhet me datë 08 Mars 2013, shpresojmë se do të realizohen bashkarisht objektivat e synuara në interes të të gjitha palëve

Ju falemnderit !

Bajram Isufi,

Drejtör Ekzekutiv

Eco-Higjiena Shpk